

VENDIM
Nr. 68, datë 3.2.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË BIBLIOTEKËS “GJERGJ FISHTA” DHE CAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit dhe të rikonstruksionit të Bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, në vlerën 117 000 000 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, për financimin e riforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, të jetë në vlerën 23 400 000 (njëzet e tre milionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për riforcimin dhe rikonstruksionin e Bibliotekës “Gjergj Fishta”.

4. Fondi për financimin riforcimit dhe të rikonstruksionit të Bibliotekës “Gjergj Fishta” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe